

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit Besian Sylja, në çështjen penale kundër të akuzuarit në R.K.nga fshati Sh., Komuna e P., për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 154 par. 1 nënë par 1 të KPK-së, sipas Aktakuzës së PPK në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.3381-11/2009 e dt.30.10.2009, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me datë 23.02.2015, në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore nga Prishtina-Fatmir Behrami, të akuzuarit, me datë 24.02.2015 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

R. K., i biri i B. dhe nënës B1. e vajzërisë M., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin Sh. Komuna e P., ku edhe jeton, me nr.personal: *numër personal...*, ka të kryer Shkollën fillore dhe dy vite shkollë të mesme, me profesion mjeshër, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa martuar, më parë i pa gjykuar, kundër tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptarë-Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me dt. 21.09.2009 rreth orës 12:40 min, në fshatin Sh. te xhamia e fshatit i pandehuri R. K., derisa ishte duke shkuar te dajt e tij në afërsi të xhamisë së fshatit është takuar me të dëmtuarin K.R. të cilin e kishte ndaluar kinse për të biseduar lidhur me faktin se i dëmtuari një ditë më parë ja kishte rrahur vëllaun e tij pas një fjalosje të dytë janë shpërndarë, K. është shkuar në shtëpi ka marr një shufër të drurit dhe është dal për tu rrahur, por pas kacafytjes i pandehuri ka arritur që me një mjet të përshtatshëm të shkaktimit të lëndimit të rëndë trupor (brisk flutur), ta godas të dëmtuarin në pjesë të ndryshme të trupit ku i shkakton plagë prerëse shpuese në anën e djathtë të gjoksit(regjionin e mames së djathtë), e përcjellur me komunikim të plagës në hapësirën e djathtë torakale dhe gjakderdhje në atë zonë të shkaktuara nga një mjet i fortë prerës-shpues, që kualifikohet lëndim i rëndë trupore.

-Me këtë ka kryer veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 154 par.1 nënpar.1 të KPK-së,

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3,11,15,34,36,38,60,64,75,76 dhe në bazë të nenit 154 par.1 nënpar.1 të KPK-së, si dhe në bazë të nenit,365,450,463, të KPPRK-së, e

G J Y K O N

I. Të akuzuarin R. (B.) K., me dënim me burg, ashtu që i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, të cilin do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën aq sa bëhen sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, si dhe në emër të shpenzimeve paushalle të paguajë shumën prej **150€ (njëqindpesëdhjetë /euro)**, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. I dëmtuari K.R. rruga “...” nga fshati Sh. Komuna e P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Konfrom nenit 60 të KPK-së, konfiskohet “Brisku Flutur” pasi që ishte objekt me të cilin ishte kryer vepra penale.

A r s y e t i m

PPK në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën, PP.nr.3381-11/2009 e dt.30.10.2009, kundër të akuzuarit R.K. nga fshati Sh., Komuna e P., për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 154 par. 1 nën par 1 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor më dt. 23.02.2015, gjatë së cilës u dëgjuan Prokurori i shtetit, dhe i akuzuari.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit i akuzuari u deklarua se e pranon në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, konstatoj se i akuzuari e pranoj fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i akuzuari është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë si dhe vlerëson se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par. 1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor, andaj Gjykata konform nenit 326 par. 1 nën par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar

procedurën e provave por ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve në kuptim të nenit 352 të KPPRK-së.

Ne fjalën përfundimtare prokurori i shtetit mbeti në tërësi pranë aktakuzës të parashtruar, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpallë përgjegjës dhe ta dënoj sipas ligjit.

Gjykata, në mungesë të dëmtuarit, edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt, e ka udhëzuar që kërkesën pasurore - juridike ta realizoj në kontest të rregullt juridiko-civil.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që e njëjti është penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 154 par. 1 nën par 1 të KPK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, ashtu që të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 64 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtim në të gjitha fazat e procedurës ishte korrekt, ndien keqardhje për të dëmtuarin, për herë të parë ka ra në kundërshtim me ligjin, e duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana rënduese gjykata gjeti motivin dhe mënyra e kryerjes së veprës penale, meqenëse nga koha e kryerjes së veprës penale kanë kaluar më tepër se 5 pesë vite, gjykata duke aplikuar dispozitat për zbutjen e dënimit në kuptim të nenit 75 dhe nenit 76 par.1 nën par. 1. 6 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe beson se ky dënim është në proporcion me peshën e veprës penale me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit, dhe është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 34 të KPK-së, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në kuptim të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.1. dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin është marrë në kuptim të nenit 60 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.435/10 e dt. 24.02.2015

Procesmbajtësi
Besian Syla

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet
Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit
Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.